



صبح بهاراں



RINGJALLJA E MËSHIRËS

(Albanian)

Shejhi i Tarikat Ameer-e-Ehli Sunnet
Themeluesi i Daveti Islami Al-Ismee Maulana Abu Bilal

MUHAMMAD ILYAS

Attar Qadiri Razavi کاتب القرآن
الرحمن الرحیم



صُبْح بَهَارَان

Subh-e-Baharan



RINGJALLJA E MËSHIRËS



Kjo broshurë u shkrua në gjuhën urdu nga Shejhu i Tarikatit dhe themeluesi i Davet-i Islami, Hazreti Al-lama Muhammed Iljas Attar Kadiri Razavi دَامَتْ بَرَكَاتُهُمُ الْعَالِيَه. Kjo broshurë është përkthyer në shqip nga përkthyesi i departamentit të përkthimit (Davet-i Islami). Nëse konstatohet ndonjë gabim në përkthim, ju lutemi të kontaktoni përkthyesin e Mexhlsit (Dawat-i Islami) dhe do të shpërbleheni nga Zoti për të.

Përgatiti:

Përkthyesi i (Dawat-i Islami)

Qendra Ndërkombëtare Medeni Fezan-e-Medine,

Ag. I. Rentis, Atina - Tel. + (30) 210-49 17 323

translation@dawateislami.net

dawateislami_athens@yahoo.

Përmbajtja

الْحَمْدُ لِلَّهِ رَبِّ الْعَالَمِينَ وَالصَّلَاةُ وَالسَّلَامُ عَلَى خَاتَمِ النَّبِيِّينَ
أَمَّا بَعْدُ فَأَعُوذُ بِاللَّهِ مِنَ الشَّيْطَانِ الرَّجِيمِ بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ

Lutja e leximit të librit

Përpara se të lexoni një libër ose mësim fetar, lexoni lutjen e mëposhtme! Në këtë rast, gjithçka që lexoni do të mbetet në mendjen tuaj إِنَّ شَاءَ اللَّهُ عَزَّوَجَلَّ. Lutja është si vijon:

اللَّهُمَّ افْتَحْ عَلَيْنَا حِكْمَتَكَ وَاَنْشُرْ
عَلَيْنَا رَحْمَتَكَ يَا ذَا الْجَلَالِ وَالْإِكْرَامِ

Përkthimi:

O Allah عَزَّوَجَلَّ, na hap dyert e diturisë dhe urtësisë dhe na lësho mëshirën Tënde! O i Madhërishëm dhe Falës!

(Mustaraf vëll 1 fq.6.Darulfikir Beirut)

Shënim: Lexoni Salat-u Selam një herë në fillim dhe një herë në fund.

Përmbajtja

Vlerat e Salavatit Sherif.....	1
Lindja e Pejgamberit (Mevludi)	2
Muxhizet (Mrekullitë)	2
Nata që ka më shumë vlerë se Nata e Kadrit	4
Nata më me vlerë midis netëve të mira	4
Lindja e të Dërguarit të Allahut dhe Ebu Lehebi	5
Myslimanët dhe Mevludi	5
Kuptimi i Mevludit dhe pjesmarrja me entuziazëm.....	6
Pejgamberi kënaqet me ata që e kuptojnë dhe manifestojnë Mevludin	7
Varja e një flamuri në ditën e Mevludit	7
Emigrimi me Flamur	7
Familja që kupton dhe manifeston Mevludin	9
Sevapi që fitohet nga kuptimi dhe manifestimi i Mevludit	12
Nderimi i hebrenjve me Islam	12
Xhemati Dawat-i Islam dhe Mevludi	15
1. Pastrimi nga mëkatet	15
2. Pastrimi i zemrës	16
3. Shiu i nurit (dritës).....	17

Përmbajtja

4. Entuziazmi shpirtëror ndihet ende sot.....	19
12 virtytet e manifestimit të Mevludit	21
Letra e Attarit për manifestimin e Mevludit.....	25
Synimi për të manifestuar Mevludin	32
Mektebe-tul Medine	38



أَلْحَمْدُ لِلَّهِ رَبِّ الْعَالَمِينَ وَالصَّلَاةُ وَالسَّلَامُ عَلَى خَاتَمِ النَّبِيِّينَ ط
أَتَابَعْتُ فَأَعُوذُ بِاللَّهِ مِنَ الشَّيْطَانِ الرَّجِيمِ ط بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ ط

RINGJALLJA E MËSHIRËS

Vlerat e Salavatit Sherif

Pejgamberi Muhammed Mustafa صَلَّى اللهُ عَلَيْهِ وَآلِهِ وَسَلَّمَ ka thënë: "Kush më dërgon salavate dhjetë herë, Allahu i Madhëruar do t'i dërgojë atij 100 bekime." (*el-Mu'xhemu'l-Evsat li't-Taberani, vëll.2, fq.252, hadithi nr: 7235*)

صَلُّوا عَلَى الْحَبِيبِ صَلَّى اللهُ عَلَى مُحَمَّدٍ

Kur vjen muaji Rabiul-Evvel, entuziazmi pranveror mbizotëron kudo. Të gjithë njerëzit që e duan zotërinë e Medinës dhe Mekës, Muhammed Mustafanë صَلَّى اللهُ عَلَيْهِ وَآلِهِ وَسَلَّمَ do të ndiejnë gëzim. Zemra e çdo myslimani të ri e të moshuar të sinqertë flet dhe thotë:

Qofshin kurban një mijë netë për muajin Rabiul Evvel

Të gjithë përveç djallit e kuptojnë këtë natë

Në një epokë kur ateizmi, politeizmi, brutaliteti dhe barbarizmi dominonin universin, një dritë e tillë zbriti në shtëpinë e Amines رَضِيَ اللهُ عَنْهَا, saqë e gjithë bota u ndriçua me këtë dritë.

Ringjallja e Mëshirës

Njerëzimi që po vdiste priste ardhjen e Tij. Ai është i Dërguari i kurorëzuar, Sulltani, Pejgamberi, njeriu zemërhapur, i lavdishëm, miku i njerëzimit. Mustafa صَلَّى اللهُ عَلَيْهِ وَآلِهِ وَسَلَّمَ u dërgua si mëshirë për të gjithë botët.

Qoftë i bekuar, Pejgamberii i fundit na nderoi dhe solli mëshirë në univers.

صَلُّوا عَلَى الْحَبِيبِ صَلَّى اللهُ عَلَى مُحَمَّدٍ

Lindja e Pejgamberit (Mevludi)

Pejgamberi i fundit صَلَّى اللهُ عَلَيْهِ وَآلِهِ وَسَلَّمَ, mëshira e botës, mik dhe besnik i Allahut, mbreti i ndershmërisë, në muajin Rabiul Evvel erdhi në botën tonë siç zbardhi dita në mëngjesin e datës së dymbëdhjetë. Ai u dha lajmin e mirë për një “lindje të bekuar” jetimëve, të vuajturve, zemërthyerve, të lënduarve e në nevojë për ndihmë dhe errësirës plot të këqija.

*O myslimanë! Gëzuar ditëlindjen e bekuar
Qoftë e bekuar ardhja e pejgamberit që sjell dritë.*

(Vesa'il-i Bahshish, fq.479)

صَلُّوا عَلَى الْحَبِيبِ صَلَّى اللهُ عَلَى مُحَمَّدٍ

Muxhizet (Mrekullitë)

Në datën e dymbëdhjetë të muajit Rabiul Evvel me lindjen e

Muhammedit صَلَّى اللهُ عَلَيْهِ وَآلِهِ وَسَلَّمَ, drita e Allahut عَزَّوَجَلَّ, retë e errëta të mosbesimit dhe shtypjes u shpërndanë. Katërmbëdhjetë shtylla (idhuj) në pallatin “Kisra” të Shahut të Iranit u shkatërruan nga një tërmet. Zjarri që digej për një mijë vjet në tempullin e zjarrit në Iran u shua. Lumi Sava u tha. Qabeja u lartësua me entuziazëm dhe idhujt u kthyen përmbys.

Qabeja u drodh me ardhjen tënde

Të gjithë idhujt u drodhën dhe ranë nga frika

(Hada'ik-i-Bahshish, fq.41)

صَلُّوا عَلَى الْحَبِيبِ صَلَّى اللهُ عَلَى مُحَمَّدٍ

I Dërguari i Allahut صَلَّى اللهُ عَلَيْهِ وَآلِهِ وَسَلَّمَ erdhi në botë si mëshirë dhe mëshirues, dhe padyshim, që kjo është dita kur zbret mëshira e Allahut xh.sh. Zoti ynë i Plotfuqishëm عَزَّوَجَلَّ thotë në Kuranin Famëllartë:

قُلْ بِفَضْلِ اللَّهِ وَبِرَحْمَتِهِ فَبِذَلِكَ فَلْيَفْرَحُوا هُوَ خَيْرٌ مِمَّا يَجْمَعُونَ ﴿٥٨﴾

“Thuaj: "Vetëm mirësisë së All-llahut dhe mëshirës së Tij le t'i gëzohen, se është shumë më e dobishme se ajo që grumbullojnë ata" (Surja Junus 58)

اَللّٰهُ اَكْبَرُ! Kurani Famëllartë jep urdhrin për të kremtuar mëshirën e Allahut. Aq sa, a ka mëshirë më të madhe se Pejgamberi ynë i Dashur صَلَّى اللهُ عَلَيْهِ وَآلِهِ وَسَلَّمَ? Shihni, është deklaruar qartë në librin tonë të famëllart, Kuranin, si më poshtë.

وَمَا أَرْسَلْنَاكَ إِلَّا رَحْمَةً لِّلْعَالَمِينَ ﴿١٠٧﴾

“E Ne të dërguam ty (Muhammed) vetëm si mëshirë për të gjitha krijesat.” *(Surja Enbija: 107)*

Nata që ka më shumë vlerë se Nata e Kadrit

Hazreti Sejjid Shejh Abdulhak Muhaddith Dehlevi رَحْمَةُ اللهِ عَلَيْهِ ka thënë: “Padyshim që Nata e Mevludit, nata në të cilën lindi Pejgamberi Muhammed mëshira e botëve صَلَّى اللهُ عَلَيْهِ وَآلِهِ وَسَلَّمَ, është më e lartë se Nata e Kadrit. Sepse është nata kur zotëria i Medinës hapi sytë në këtë botë. Në fakt, Nata e Kadrit është një natë që i është dhënë Pejgamberit tonë Muhammed صَلَّى اللهُ عَلَيْهِ وَآلِهِ وَسَلَّمَ. Ajo natë, e cila u nderua me lindjen e zotërisë së gjithësisë, zotëria i gjithësisë, u nderua me zbritjen e engjëjve në dynja, prandaj është edhe më e virtyshme se Nata e Kadrit. *(Masebete bi’s-Sunne, fq.100)*

Nata më me vlerë midis netëve të mira

Dita e dymbëdhjetë e muajit Rabiul Evvel është nata më e virtyshme nga të gjitha netët e mira për myslimanët. Në të vërtetë, nëse zotëria I nurit nuk do të kishte ardhur në këtë botë si mëshirë për detet dhe tokat, nuk do të kishte as festë dhe as ditë të bekuara. Për më tepër, e gjithë madhështia dhe lavdia e njeriut dhe e botës, mëshira e botëve, përtej vendeve, i Dashuri i Mëshiruesit صَلَّى اللهُ عَلَيْهِ وَآلِهِ وَسَلَّمَ është lëmosha e pluhurit të këmbëve të tij.

Nuk kishte bukuri pa të, prania e tij i jepte kuptim universit

Ai është jeta e botës, bota u krijua me jetë.

(Hada'ik-i Bahshish, s.126)

صَلُّوا عَلَى الْحَبِيبِ صَلَّى اللَّهُ عَلَى مُحَمَّدٍ

Lindja e të Dërguarit të Allahut dhe Ebu Lehebi

Kur vdiq Ebu Lehebi, disa nga familjarët e tij e panë atë në një gjendje të keqe në ëndrra dhe e pyetën: - "Çfarë ke parë? Ai u përgjigj; "Nuk pashë ndonjë të mirë kur u largova nga ju". Pastaj ai tregoi vrimën nën gishtin e madh dhe tha: "Më jepet vetëm ujë nga këtu". Dhe kjo sepse lirova robëreshën Suvejbe. (*Abdurrezzak, vll.9; fq.9, Hadithi Nr.16661, 'Umdetu'l-Kari, vll.14, fq.44; Tahtu'l-Hadith, 5101*). Al-lame Bedruddin-el Ajni رَحْمَةُ اللَّهِ عَلَيْهِ duke komentuar këtë tha; -"Ajo që nënkuptohet këtu është se Ebu Lehebit iu dha një sasi shumë e vogël uji." (*'Umdetu'l-Kari, F'za*)

Myslimanët dhe Mevludi

Lidhur me këtë, Hazreti Sejjid Shejh Abdulhak Muhaddith Dehleui رَحْمَةُ اللَّهِ عَلَيْهِ thotë: -"Kjo ngjarje i ka ndodhur të Dërguarit të Allahut صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَآلِهِ وَسَلَّمَ. Kjo është një dëshmi shumë e mirë për ata që e mobilizohen dhe shpenzojnë për Muhammedin dhe për lindjen e tij. . Domethënë, edhe Ebu Lehebi, i cili ishte politeist, u gëzua me lajmin për lindjen e Pejgamberit të Pejgamberëve, dhe robëreshës së tij Suvejbe, nëse

Ringjallja e Mëshirës

ai shpërblehet vetëm se e liroi për të ushqyer me gji Pejgamberin, kushedi se si shpërblehet myslimani që ka dashurinë e Pejgamberit në zemrën e tij dhe e mobilizon pasurinë e tij për kauzën e Tij. Megjithatë, në natën e Mevludit duhet shmangur muzika me tekste dhe instrumente.

(Medarixhu'n-Nubuvve, vll.2, fq.19)

صَلُّوا عَلَى الْحَبِيبِ صَلَّى اللَّهُ عَلَى مُحَمَّدٍ

Kuptimi i Mevludit dhe pjesmarrja me entuziazëm

Të dashur vëllezërit e mi besimtarë, përqafoni natën e mirë të Mevludit me shumë entuziazëm. Nëse edhe një politeist si Ebu Lehebi shpërblehej për faktin se ishte i lumtur me lindjen e Pejgamberit tonë të dashur 'صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَالْهٖ وَسَلَّمَ' ne si myslimanë si mund të privohemi? Nëse Ebu Lehebi shpërblehej jo sepse kishte ardhur në këtë jetë i Dërguari i Allahut, por vetëm se i lindi nipi i tij. Po nëse ne për hir të Allahut gëzohemi dhe mobilizohemi se ka ardhur Pejgamberi ynë 'صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَالْهٖ وَسَلَّمَ' dhe e kuptojmë ardhjen e tij në këtë botë, a do të na e ndalojë ndonjëherë Zoti ynë mëshirën e Tij mbi ne?

Pejgamberi i Pejgamberëve hyri në shtëpinë e Amines

Jini të lumtur, o ju të trishtuar dhe të pikëlluar. Ka ardhur një zotëri për t'ju ngushëlluar.

(Vesa'il-i Bahshish, fq.474)

صَلُّوا عَلَى الْحَبِيبِ صَلَّى اللَّهُ عَلَى مُحَمَّدٍ

Pejgamberi kënaqet me ata që e kuptojnë dhe manifestojnë Mevludin

Një dijetar thotë: **اَلْحَمْدُ لِلّٰهِ عَزَّوَجَلَّ** pata nderin të shoh Resulin, Pejgamberi i Pejgamberëve. Unë e pyeta: - "O i Dërguari i Allahut! A jeni të kënaqur me këtë vepër të myslimanëve që çdo vit festojnë me entuziazëm ditëlindjen tënde të bekuar? Në përgjigje ai tha: - "Kush është i kënaqur me mua, edhe unë do të jem i kënaqur me të." (*Tedhkiretu'l-Vaidhin, fq.600*)

Varja e një flamuri në ditën e Mevludit

Nëna e dashur e Pejgamberit tonë, Amineja **رَضِيَ اللهُ عَنْهَا** ka thënë: Kur lindi Pejgamberi **صَلَّى اللهُ عَلَيْهِ وَآلِهِ وَسَلَّمَ** pashë se ishin ngritur tre flamurë, i pari në lindje, i dyti në perëndim, i treti mbi Qabe. (*Hasais-i Kubra, vll.1, fq.82*)

Ruhul-ul-Emini e ngriti flamurin në çatinë e Qabesë

Ai u ngrit në qiell natën e lindjes së tij të bekuar

(Zevk-i Na'at, 67)

Emigrimi me Flamur

Ndërsa Pejgamberi ynë **صَلَّى اللهُ عَلَيْهِ وَآلِهِ وَسَلَّمَ** i cili u dërgua si mëshirë për botët, ishte duke u shpërngulur për në Medine, kur arritën në rajonin "Gamim" që ndodhej rreth Medinës së bekuar, Buride Eslami bashkë me shtatëdhjetë kalorës erdhi për të kapur Pejgamberin **صَلَّى اللهُ عَلَيْهِ وَآلِهِ وَسَلَّمَ**. Atij i bënë përshtypje shikimet e

Ringjallja e Mëshirës

bekuara të Pejgamberit tonë Muhammed صَلَّى اللهُ عَلَيْهِ وَآلِهِ وَسَلَّمَ dhe ushqe u ndjenja dashurie ndaj tij. Ai u nderua duke pranuar Islamin me gjithë kolonën e tij dhe tha: -“O i Dërguar i Allahut صَلَّى اللهُ عَلَيْهِ وَآلِهِ وَسَلَّمَ! “Hyrja juaj në Medine le të jetë me flamur”. Pastaj hoqi çallmën, e lidhi në një shtizë dhe u nis para zotërisë së Medinës, Sulltanit të Zemrave صَلَّى اللهُ عَلَيْهِ وَآلِهِ وَسَلَّمَ. (Vefau'l-Vefa, vll.1, fq.243)

Allahu e nderon të dashurin e Tij

Sot nderohet peygamberi më i madh

Pse ka erëra të këndshme në hapësirë! Pse shtëpitë janë të ndritshme?

Faleminderit Zotit! Zotëria ynë ka ardhur

Nata më e virtytshme kanë ardhur me mëshirën e Zotit

Mbreti i virtytit dhe i bujarisë ka ardhur

Huritë këndojnë poezi

Mbërrin peygamberi i engjëjve dhe hurive

Mbreti i deteve dhe i tokave, peygamber i peygamberëve

Ai vjen në shtëpinë e Amines

Gjoksi i Attarit po fryhet nga lumturia

I dashuri i tij nderon botën tonë

(Vesa'il-i Bahshish, fq.445)

صَلُّوا عَلَى الْحَبِيبِ صَلَّى اللهُ عَلَى مُحَمَّدٍ

Familja që kupton dhe manifeston Mevludin

Një burrë i quajtur Ibrahim, i cili kishte një dashuri të thellë për Pejgamberin e Islamit, jetonte në Medine. Të ardhurat i fitonte gjithmonë me mjete hallall dhe gjysmën e të ardhurave e ndante për të festuar lindjen e bekuar. Kur vinte muaji i bekuar i lindjes, e respektonte me shumë kujdes dhe në kuadër të procedurave fetare. Shpërndante shumë ushqime dhe shpenzonte pasurinë e tij për vepra të mira për sevapin e Habibullahut صَلَّى اللهُ عَلَيْهِ وَآلِهِ وَسَلَّمَ. Gruaja e tij, ashtu si ai, ushqente të njëjtat ndjenja ndaj Pejgamberit صَلَّى اللهُ عَلَيْهِ وَآلِهِ وَسَلَّمَ, duke iu bashkuar bamirësisë me shumë entuziazëm. Edhe pasi gruaja e tij ndërroi jetë, Ibrahim i vazhdoi këto zakone pa ndërprerje. Një ditë, Ibrahim, i cili ishte i përkushtuar ndaj Pejgamberit të Allahut, i bëri këtë testament djalit të tij:

“Djali im i dashur! Unë do të bashkohem me pronarin tim të vërtetë sonte. Të gjitha kursimet e mia përbëhen nga 50 dirhemë dhe 19 metra pëlhurë. "Shpenzoheni pëlhurën për varrim dhe paratë për bamirësi nëse është e mundur." Pastaj ai recitoi dëshminë dhe ia dorëzoi shpirtin Zotit.

Djali i tij, pas vullnetit të tij, e përcolli babanë e tij të ndjerë në udhëtimin e tij të fundit. Ai nuk dinte si t'i shpenzonte për bamirësi 50 dirhemët e trashëguar nga i ati. Kur e zuri gjumi natën me këtë mendim, dëgjoji në ëndërr se ishte bërë kijameti dhe ngriheshin britma nga kudo. Ata që bënë vepra të mira hynë në xhennet, kurse ata që bënë vepra të këqija u tërhoqën zvarrë

në xhehennem. Ai priste se çfarë vendimi do të merrej për të. Ndërkohë dëgjoji një zë nga jashtë:

"Lëreni këtë djalë të ri të hyjë në xhennet." Pas kësaj, ai u gëzua dhe hyri në xhennet dhe filloi të rrotullohej përreth. Pasi vizitoi shtatë qiejt, kur përparoi në qiellin e tetë, rojtari i qiellit, Hz. Ridvan i thotë:

"Këtë parajsë mund të hyjnë vetëm ata që e kuptojnë lindjen e Pejgamberit tonë Muhammed ﷺ në muajin Rabiul Evvel." Kur e dëgjoji këtë, ai kuptoi se prindërit e tij të ndërë mund të ishin brenda. Pastaj dëgjoji përsëri një zë:

"Lëreni të hyjë këtë të ri, nëna dhe babai i tij duan ta shohin." Më pas, ai hyri brenda dhe pa se nëna e tij e ndërë ishte ulur buzë lumit Kevther, një plakë ishte ulur në fron pranë saj dhe disa zonja të respektuara ishin ulur në karriget rreth saj. Ai pyeti një engjëll:

"Cilat janë këto zonja?" Engjëlli tha: -"Zonja në fron është. Fatmatu'z-Zehra رضى الله عنها. Në karrige është Hatixheja, Aisheja, Maria, Asija, Sara, Haxherja, Rabia dhe Hz. Zubejde رضى الله عنهن." Ai u gëzua shumë dhe shkoi pak më tej. Para tij doli një fron shumë i madh. Mbi të është Zotëria i Medinës, Halifi i dy botëve, i Dërguari i Allahut, Pejgamberi Muhammed ﷺ. Ai e pa atë të ulur me fytyrën e tij të ndritshme dhe të bekuar. Halifët e Islamit (Hulefa-i Rashidin) ishin ulur në katër ulëset pranë tij. Pejgamberët e Allahut të Madhërishëm ishin ulur në ndenjëset e arta në të djathtë, dhe ata që u ngritën në shkallën e shehidit

në rrugën e Allahut ishin ulur në të majtë. Ndërkaq, babai i tij i ndjerë, Ibrahim, doli para tij nga një turmë pranë Pejgamberit Muhammed. Babai i tij përqafoi djalin e tij. Djali i tij ishte shumë i lumtur për këtë dhe e pyeti:

"Baba! Si e arrite nderin për të qenë në një post kaq të lartë?

Babai i tij u përgjigj: **اَلْحَمْدُ لِلّٰهِ عَزَّوَجَلَّ**! Ky është shpërblimi për realizimin e ditëlindjes së bekuar të Pejgamberit tonë. Pikërisht në këtë moment i riu u zgjua nga gjumi.

Në mëngjes ai e shiti shtëpinë e tij pa interes dhe mbi të vuri 50 dirhemët e trashëguar nga babai i tij i ndjerë dhe ushqeui dijetarët. Ai u tërhoq nga dëshirat e botës së vdekshme dhe filloi të kalonte gjithë kohën e tij duke u falur dhe duke i shërbyer xhamisë. Tridhjetë vitet e mbetura të jetës së tij i kaloi në këtë mënyrë. Pas vdekjes së tij, dikush e pa në ëndërr dhe tha:

“Çfarë ke hasur?” - “Më dërguan te babai im në xhennet sepse e kuptova ditëlindjen e Pejgamberit tonë.

(Tedhkiretu'l-Va'idhin, fq.557)

Allahu **عَزَّوَجَلَّ** e mëshiroftë dhe na faltë nëpërmjet tij!

أَمِينٌ بِجَاهِ النَّبِيِّ الْأَمِينِ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَآلِهِ وَسَلَّمَ

O Zoti im! Na fal për hir të ditës që lindi Pejgamberi ynë

Libri i veprave të mia është plot me mëkate që kam kryer

(Vesa'il-i Bahshish, fq.477)

صَلُّوا عَلَى الْحَبِيبِ صَلَّى اللَّهُ عَلَى مُحَمَّدٍ

Sevapi që fitohet nga kuptimi dhe manifestimi i Mevludit

Shejh Abdulhak Muhaddis Dehlevi رَحْمَةُ اللهِ عَلَيْهِ thotë: Zoti ynë i Plotfuqishëm do t'i shpërblejë ata që e kremtojnë natën e lindjes së zotërisë së Medines, Pejgamberit Muhammed صَلَّى اللهُ عَلَيْهِ وَآلِهِ وَسَلَّمَ, me bekimet e tyre fetare. Myslimanët kanë qenë gjithmonë ata që e festojnë ditëlindjen e Muhammedit صَلَّى اللهُ عَلَيْهِ وَآلِهِ وَسَلَّمَ, duke e festuar atë me të tjerët, japin ushqim e pije, japin lëmoshë me bollëk dhe bëjnë bamirësi. Ata shprehin hapur lumturinë e tyre dhe japin bujarisht. Ata madje këndojnë poezi për të Dërguarin e Allahut, mblidhen për të kujtuar këtë festë dhe zbukurojnë shtëpitë e tyre. Me respektin dhe bekimin e veprave të tilla të mira, Allahu do të dërgojë mëshirën e Tij mbi ta. *(Masebete mine's-Sunne, fq.102)*

Nderimi i hebrenjve me Islam

Hazreti Abdul Vahid bin Ismail رَحْمَةُ اللهِ عَلَيْهِ thotë: Në Egjipt jetonte një person që kishte një dashuri të madhe për të Dërguarin e Allahut صَلَّى اللهُ عَلَيْهِ وَآلِهِ وَسَلَّمَ. Në muajin e bekuar Rabiul-Evvel, ai e kremtonte bukur natën në të cilën lindi Habibullahi صَلَّى اللهُ عَلَيْهِ وَآلِهِ وَسَلَّمَ. Një herë fqinja i tij hebre i tha burrit të saj:

“Pse fqinji ynë mysliman i ushqen të uriturit në këtë muaj çdo vit?

Burri i saj çifut tha: -“Pejgamberi që ata besojnë lindi në këtë

muaj. Prandaj, ata e kremtojnë natën në të cilën Ai ka lindur. “Myslimanët e vlerësojnë shumë këtë muaj”.

Atëherë gruaja i tha: - “Sa e bukur është kjo vepër e myslimanëve. “Çdo vit ata kremtojnë natën në të cilën lindi Pejgamberi i tyre”. Kur gruan hebreje e zuri gjumi natën, fati i saj u hap papritur. Në ëndrrën e saj, ajo pa një person me fytyrë të ndritshme duke ardhur, njerëzit u mblodhën rreth tij. Gruaja shkoi përpara dhe pyeti një nga njerëzit atje:

“Kush është ky njeri i respektuar? Personi që ajo pyeti u përgjigj: "Ky person që shihni është pejgamberi i fundit Muhammed صَلَّى اللهُ عَلَيْهِ وَآلِهِ وَسَلَّمَ, i Dërguari i Allahut, i cili u dërgua si mëshirë për botët. “Fqinji i saj, i cili është mysliman, e kremtoi natën e lindjes së tij prandaj dhe erdhi për ta parë, për t'i dhënë bekime dhe për t'u shprehur se ishte shumë i kënaqur me veprat e tij. Këtë herë gruaja përsëri tha: - “Dëshiroj t'i bëj një pyetje Pejgamberit tuaj. Nuk e di nëse ai do të përgjigjet? Burri: - "Sigurisht.". Gruaja hebreje i thirri Pejgamberit Hz. Muhammed صَلَّى اللهُ عَلَيْهِ وَآلِهِ وَسَلَّمَ:

Pejgamberi ynë صَلَّى اللهُ عَلَيْهِ وَآلِهِ وَسَلَّمَ përgjigjet -“Lebbejk”. Gruaja kur e dëgjoi këtë, i bëri shumë përshtypje dhe tha: - “Edhe pse nuk jam myslimane, ju prapëseprapë më keni përshëndetur me fjalën “Lebbejk”. Zotria i Medinës, qetësia e zemrave صَلَّى اللهُ عَلَيْهِ وَآلِهِ وَسَلَّمَ tha:

"Është shpallur nga Allahu se do të nderoheni me Islamin." Sapo gruaja hebreje dëgjon këtë:

Ringjallja e Mëshirës

-“Pa dyshim, ti je peygamber i Allahut dhe ke moral të madh. Ai që nuk ju bindet do të shkatërrohet. "Kushdo që nuk e di vlerën tuaj do të zhgënjehet shumë." Ajo tha fjalën e dëshmisë (shehadetin).

Gruaja pastaj u zgjua nga gjumi dhe sinqerisht u bë myslimane. Ajo e dha të gjithë pasurinë e saj në rrugën e Pejgamberit të dashur të Allahut. Ajo vendosi t'i shpenzonte paratë e saj për të realizuar plotësisht lindjen e bekuar të Muhammedit صَلَّى اللهُ عَلَيْهِ وَآلِهِ وَسَلَّمَ. Kur u zgjua në mëngjes, pa të shoqin duke përgatitur ushqime të shijshme. Në habi pyeti:

-“Çfarë po bën?”

Burri i saj i tha: - “Më vjen shumë mirë që je nderuar me Islamin. Prandaj gatuj për të ushqyer të varfërit”.

Gruaja përsëri pyeti: - “Si e kuptove këtë?”

Kësaj pyetjeje burri i saj iu përgjigj: - “Edhe unë u nderova me Islamin duke zgjedhur rrugën e treguar nga Muhammedi صَلَّى اللهُ عَلَيْهِ وَآلِهِ وَسَلَّمَ.”

Zoti i Madhëruar i mëshiroftë. Na faltë edhe ne nëpërmjet tyre.

أَمِينٌ بِجَاهِ النَّبِيِّ الْأَمِينِ صَلَّى اللهُ عَلَيْهِ وَآلِهِ وَسَلَّمَ

Me ardhjen e Pejgamberit, shtypja mori fund

Toka dhe qielli janë të mbushura me dritë

(Vesa'il-i Bahshish, s.476)

صَلُّوا عَلَى الْحَبِيبِ صَلَّى اللهُ عَلَى مُحَمَّدٍ

Xhemati Dawat-i Islam dhe Mevludi

اَلْحَمْدُ لِلّٰهِ عَزَّوَجَلَّ "Dawat-i Islami", i cili përpiket të përhapë Kur'anin dhe Sunnetin në mbarë botën dhe vepron jashtë politikës, ka metodën e tij unike për të kuptuar lindjen e bekuar. Festimet madhështore të ditëlindjeve organizohen nga Davet-e-Islami në shumë vende. Ndoshta programi më i madh në botë "Takimi i Mevludit" mbahet në Babu'l-Medine në Karaçi, Pakistan. Përfitimet dhe bekimet që këto programe madhështore u sjellin njerëzve janë të panumërta. Kushedi se sa njerëz kanë marrë pjesë në këto programe të dobishme dhe kanë përjetuar ndryshime sociologjike në jetën e tyre. Lidhur me këtë temë, ju rekomandojmë të rishikoni librin "Katër ndryshime sociologjike".

1. Pastrimi nga mëkatet

Një person që e donte shumë Pejgamberin صَلَّى اللهُ عَلَيْهِ وَآلِهِ وَسَلَّمَ thotë: Një i njohur im, i cili nuk ka interes për fenë apo për adhurimin dhe është materialist, mori pjesë në "Ditëlindjen e Bekuar" në Babu'l-Medina në Karaçi të Pakistanit". Kur u zgjua atë mëngjes dhe filloi të shpërndahej ushqimi, jehona e Salavatit Sherif dhe fjalët "Mirë se erdhe, o Mustafa!" Zërat e tyre i bënë shumë përshtypje. Brenda tij lindi dëshira për t'u kthyer te mirësia dhe për të shmangur mëkatet. Ai filloi të synojë të falej rregullisht dhe të rriste mjekrën.

Pasi kjo ndodhi, ai fatmirësisht kishte braktisur një ves të keq

Ringjallja e Mëshirës

që e përsëriste vazhdimisht – që nuk është me vend të përmendet këtu – me bekimin e “Takimit të Bekuar të Lindjes”. Me fjalë të tjera, një njeri që e kishte bërë zakon të mëkatonte, e gjeti zgjidhjen e problemit të tij duke marrë pjesë në programin "Takimi i Bekuar i Lindjes".

Kërkoni mëshirën dhe bekimet e tij në këtë natë të bekuar.

Kërkoni pastrim nga rebelimi dhe mëkati

صَلُّوا عَلَى الْحَبِيبِ صَلَّى اللهُ عَلَى مُحَمَّدٍ

2. Pastrimi i zemrës

Do të doja të ndaja me ju këtu, sa më shpejt që të mundem, deklaratat e shkruara nga një vëlla mysliman që jeton në pjesën veriore të qytetit të Karaçit:

“Në ditët e para të muajit Rabiul-Evvel, disa njerëz që iu përkushtuan të Dërguarit të Allahut ftuan një person mëkatar dhe të padevotshëm si unë në “Programin e Lindjes së Bekuar” të organizuar nga Dawat-e-Islami në Babul- Medine në Karaçi. Me kënaqësi e pranova ftesën. Natën e dymbëdhjetë të muajit, mbajta premtimin dhe hipa në autobus me një grup të madh vëllezërisht myslimanë për të marrë pjesë në Programin e Lindjes së Bekuar. Njëri prej tyre shpërndau një ëmbëlsirë të quajtur "Çam Çam" për rreth tridhjetë persona në autobus. Mënyra e tij e dhembshur për të dhënë më preku thellë. Pas pak arritëm te “Programi i Lindjes së Bekuar”. Ishte hera e parë

në jetën time që shikoja një ambient që më përkëdhelte aq shumë shpirtin. Poezitë, salavatet, përshëndetjet dhe thirrjet entuziaste si “Paqja qoftë mbi ty o Pejgamber”, faleminderit Zotit, ma pastroi zemrën e errësuar. Ky mjedis shpirtëror i Thirrjes Islame nuk ishte më i huaj për mua. Falë Zotit, tani kam një mjekër në fytyrë dhe një sarik në kokë. Për më tepër, deri në momentin që shkrova këtë artikull, pata nderin të shërbeja si zyrtar fetar për të përhapur Sunnetin e Pejgamberit.

Mirësia dhe hiri i Zotit janë në këtë ambient shpirtëror

Ky është vendi i mirësisë dhe i bujarisë

Është vendi ku mësohet sunneti

Frika ndaj Zotit ndihet këtu

Kushdo që thith këtë ajër

Fuqia dhe vlera e tij janë të njohura

(Vesa'il-i Bahshish, fq.604)

صَلُّوا عَلَى الْحَبِيبِ صَلَّى اللهُ عَلَى مُحَمَّدٍ

3. Shiu i nurit (dritës)

Pas namazit të ikindisë në 1417 vjetorin e lindjes së bekuar, përfaqësuesit e degës Nazimabad të Davet-i Islami në Pakistan thanë: "Mirë se erdhe në këtë ditë të bekuar" dhe "Mirë se erdhe o Mustafa صَلَّى اللهُ عَلَيْهِ وَآلِهِ وَسَلَّمَ" Ata po kalonin nëpër rrugët e Karaçit duke kënduar i ndalonin njerëzit aty-këtu dhe i

Ringjallja e Mëshirës

këshillonin të bënin vepra të mira. Në një vend, një djalë dhjetëvjeçar orator po i ftonte njerëzit në vepra të mira. Papritur, heshtja mbretëroi në turmë. Kur fjalimi i tij mbaroi, dikush nga turma gjeti udhëheqësin e grupit dhe tha i tronditur:

-“Kam parë me sytë e mi se drita po binte mbi të gjithë turmën, ndërsa ju dhe ky djali i vogël iu drejtuan njerëzve. "Unë jam jomysliman, ju lutem më pranoni në Islam!"

Qielli bëri jehonë me tinguj "mirëseardhje". Në atë moment, klima shpirtërore dhe thirrja islame e krijuar nga turma që u mbledh me rastin e lindjes së bekuar të Pejgamberit tonë Muhammed صَلَّى اللهُ عَلَيْهِ وَآلِهِ وَسَلَّمَ, në sajë të organizimit të frytshëm. Pasi u nderua me Islamin, ky person tha: djalli u mund.

“إِنَّ شَاءَ اللهُ عَزَّوَجَلَّ” “Do ta ftoj edhe familjen time në Islam”. Ai u largua nga ambienti duke thënë: Në fakt, ai bëri atë që tha. Përpjekjet e tij dhanë fryte dhe gruaja, 3 fëmijët dhe babai i tij e përqaftuan Islamin.

*Ditëlindja e bekuar ka ardhur, zemra ime është e lumtur
Nata e vërtetë e të dashuruarve është data 12 e Rebijul-Evvelit.*

*Sot çdo engjell dhe çdo huri është i lumtur
Por djalli është i pakënaqur dhe i dëshpëruar sot*

صَلُّوا عَلَى الْحَبِيبِ صَلَّى اللهُ عَلَى مُحَمَّدٍ

4. Entuziazmi shpirtëror ndihet ende sot

Një person që është i dashuruar pas Pejgamberit shpjegon kështu: - "Natën e lindjes së tij të bekuar, ne së bashku me disa vëllezër fetarë, morëm pjesë në natën madhështore të organizuar nga Davet-i Islami, "Lindja e Bekuar" ndoshta kjo ishte më e madhja në botë, në Babu'l-Medina në Karaçi. Gjatë bisedës, dikush tha: -"Në të kaluarën, "Programet e lindjes së lumtur" të Davet-i Islamit ishin mjaft mbresëlënëse. Por tani nuk është kështu." Duke dëgjuar këtë fjalë, tjetri tha:

-"Shoku im! Këtu e keni gabim, pjesëmarrja në program është mjaft e lartë, entuziazmi është i njëjtë, por emocionet brenda nesh nuk janë si më parë. Si mund të ndryshojë mjedisi shpirtëror në një vend ku përmendet Muhammed Mustafaja صَلَّى اللهُ عَلَيْهِ وَآلِهِ وَسَلَّمَ? Nuk është gjë tjetër, veçse ndryshimi i mentalitetit tonë." Nëse e kujtojmë bukurinë e Pejgamberit tonë صَلَّى اللهُ عَلَيْهِ وَآلِهِ وَسَلَّمَ me shpirt dhe dëgjojmë fjalët e Allahut, pa u kapur me kritika, me lejen e Zotit, ne mund të bekohemi shpirtërisht. Fjalët e shqiptuara nga vëllai ynë që bëri pyetjen, të kapur nga vesveset, gati sa nuk na bënë të humbnim entuziazmin dhe të privoheshim nga ky mjedis shpirtëror, duke na bërë të ktheheshim në shtëpi. Megjithatë, përgjigja e dhënë nga personi tjetër ishte e dobishme për të hapur syrin e zemrës sonë dhe për ta larguar vesvesen e shejtanit. Kjo përgjigje e mprehtë më bëri jehonë. U mblodha dhe hyra në atmosferën e mjedisit shpirtëror dhe u bashkova me ata që e duan Pejgamberin Muhammed dhe recitova salavatet sherifë. Dielli kishte filluar të lindte. Të dashuruarit e Pejgamberit

